

BREAKING NEWS

x

E VERTETA E GRABITJES SE THESARIT NE KRRABE, DALIN NE DRITE DETAJET/ ARTA...

AKTUALITET

Policia del me njoftim zyrtar: Shpallen në kërkim 3 autorët, 23 persona të shoqëruar. Ja pse i ekzekutuan dy të rinjtë në Laç

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
29 PRILL 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Policia e Shtetit ka dalë me njoftim zyrtar lidhur me ekzekutimin e dyfishtë në Laç. Sipas hetimeve të kryera, ka rezultuar se ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta pas një konflikti të çastit.

Njoftimi i Policisë

"Identifikohen dhe shpallen në kërkim autorët e dyshuar të vrasjes së dy shtetasve, ndodhur mbrëmjen e djeshme.

Në lidhje me ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e djeshme në lagjen nr. 1 Laç, Kurbin, ku pas një konflikti për motive të dobëta u plagosën me armë zjarri dy shtetas të cilët më pas gjetën vdekjen në një nga spitalet private në Tiranë, Policia ngriti një grup të posaçëm hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin për zbardhjen e kësaj ngjarjeje.

Menjëherë sa është marrë njoftimi, në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e Policisë së Kurbinut si dhe grupi hetimor. Në vijim janë ngritur pika kontrolli në të gjitha rrugët që lidhen me qytetin e Laçit si dhe disa pika kontrolli në akset kryesore rrugore, Milot -Lezhë, Milot -Kurbin -Tiranë.

Me mbështetjen e FNSH, janë kryer një sërë kontrollesh në banesa e vende të dyshimta ku mund të ishin fshehur autorët, si dhe janë shoqëruar në Komisariatit e Policisë, 23 persona të cilët u pyetën në lidhje me ngjarjen.

Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera nga grupi i posaçëm hetimor, rezultoi se ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta, pas një konflikti të çastit, dhe se autorët e dyshuar të vrasjes janë shtetasit: M. B., 25 vjeç, M. B., 23 vjeç dhe V. B., 28 vjeç, të tre lindur e banues në Kurbin.

Policia e Kurbinut vijon kontrollet intensive për gjetjen dhe kapjen e autorëve të dyshuar.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Pare Kurbin, për veprime të mëtejshme hetimore, për veprat penale "Vrasja në rrethana të tjera të